



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **DREJTORIA E ARSIMIT**

**Nr. 05/27**

**Data: 24.01.2022**

**P O D U J E V Ë**

Në bazë të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Kosovës, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, Ligji për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, nenit 12 paragrafi 6, i UA 08/2021, Drejtoria për Arsim shpall:

## **K O N K U R S** **PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS**

**Titulli i vendit të punës: edukatore 0-3 vjeç**

**Numri i pozitave: 2 (dy)**

**Titulli i vendit të punës: edukatore 3-6 vjeç**

**Numri i pozitave: 3 (tre)**

**Orari i punës: 40 orë në javë**

**Kohëzgjatja e kontratës: deri më 31.08.2022**

**Data e njoftimit: 24/01/2022 - 22.02.2022** (<https://konkursi.rks-gov.net>)

**Afati për aplikim: 23/02/2022 - 09/03/2022**

### **KUSHTET DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE:**

#### **Kriteret e kualifikimit për m. edukatore 0-3 vjeç:**

- Fakulteti i Edukimit- programi katër vjeçar i nivelit bachelor për edukimin në fëmijërinë e hershme 0-3 vjeç;
- Shkolla e mesme e mjeksisë-drejtimi infermiere edukatore;
- Shkolla e mesme e mjeksisë-drejtimi i pediatriisë;
- Shkolla e mesme e mjeksisë-drejtimi mami;
- Shkolla e mesme e mjeksisë së përgjithëshme.

#### **Kriteret e kualifikimit për edukatore 3-6 vjeç:**

- Fakulteti i Edukimit- programi katër vjeçar i nivelit bachelor për edukimin parashkollor;
- Shkolla e Lartë Pedagogjike- drejtimi për edukatorë;
- Fakulteti Filozofik- dega e pedagogjisë së përgjithëshme;
- Programi përkujdesje-mirëqenie e fëmijëve.

**VËREJTJE:** Sipas Udhëzimit Administrativ (MASHTI) NR.05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, neni 4 paragrafi 1 (çerdhja e fëmijëve 0-3 vjeç) , paragrafi 2 (kopshti i fëmijëve 3-6 vjeç) neni 12 paragrafi 6, i UA 08/2021 “Të gjithë kandidatët e kualifikuar sipas këtyre nenve i plotësojnë kriteret për punësim”.

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

#### **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve);
- Rezymeja personale (CV);
- Diplomat e kualifikimit (kopja e vërtetuar);
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmitë mbi përvojën e punës (nëse ka);
- Çertifikata e lindjes;
- Vërtetimi nga gjykata kompetente se personi nuk është nën hetime.

#### **Afati i konkursit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes, pra nga data:23.02.2022 deri më datë 09.03.2022. dhe është i publikuar në portalin për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe në web-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve/>

#### **Mënyra e aplikimit**

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në portalin për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). apo t'i shkarkojnë nga web faja zyrtare e Komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve/> dhe të plotësuara t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Podujevës.

*Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.*

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave kandidatët do të informohen përmes njoftimeve të cilat do të publikohen në web faqen e Komunës së Podujevës dhe në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës, pas mbylljes së konkursit.

#### **Sqarim:**

Kandidatët të cilët gjatë testit me shkrim marrin 50% të pikëve do të ftohen në intervistë me gojë.

- Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmëri pas përfundimit të procedurave të rekrutimit në këtë konkurs, por në varësi të lirimit real të vendit të punës në IEAA (hapjes së çerdhes, datës së pensionimit, pushimit të lehonisë apo pushimeve tjera të rregulluara me ligj).
- Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2021-2022. Në rast të ndonjë nevoje eventuale për edukatore në çerdhe, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave pritëse.

**Drejtori i DKA-së**

**Avni Fetahu**

